

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM
Nr.423, date 2.7.2004

PER RRRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TE USHTARAKEVE DHE TE PENSIONEVE FAMILJARE TE FAMILJEVE TE PILOTEVE QE KANE HUMBUR JETEN NE PERMBUSHJE TE DETYRES GJATE FLUTURIMIT

Ne mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakeve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Sherbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar, dhe të nenit 1 të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit", të ndryshuar me propozimin e ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensionet suplementare të ushtarakeve të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakeve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Sherbimit Informativ Shtetëror", të ndryshuar me datë fillimi deri më 30.6.2004, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.
2. Pensionet familjare, të eaktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit", të ndryshuar, me datë fillimi ciferë më 30.6.2004, përfshirë edhe këtë datë, të rriten në masën 8 për qind.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2004 llogariten në shumën 50 100 000 (pesëdhjetë milionë e njëqind mijë) lekë dhe të përballohen nga buxheti i vitit 2004, parashikuar për sigurimin suplementar të ushtarakeve.
4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletorën zyrtare" dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI
FATOS NANO

Në mungesë dhe me porosi

ZEVENDESKRYEMINISTRI
NAMIK DOKLE

**MINISTRI I PUNES
DHE I ÇESHTJEVE SOCIALE
ENGJELL BEJTAJ**